

## Vota e Diasporës

### Ministri Majko viziton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko ka zhvilluar një takim me kryetarin e Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Klement Zguri, sekretarin e përgjithshëm Ylli Merkaj, anëtarin Bledar Skenderi si dhe Drejtoreshën e marrëdhënieve me jashtë Elvira Goxholli në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Tema e takimit lidhej me ecurinë e procesit të votimit të Diasporës në zgjedhjet e ardhshme, të cilat do të mbahen më 25 prill 2021 me dekretin e Presidentit të Republikës. Në fokus të takimit ishte diskutimi për mbarëvajtjen së procesit përgatitor për aplikimin e votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit në zbatim të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor. Ministri Majko theksoi nevojën e sigurimit për vazhdimësinë institucionale të akteve dhe vendimeve të marra deri tani me qëllim që zgjedhja e anëtarëve të rinj të KQZ mos krijojë vonesa. Propozimi i ministrit Majko ishte fillimi i punës bashkëpunuese të institucionit të KQZ me ministrinë e brendshme dhe drejtorinë e gjendjes civile. E rëndësishme është të fillojnë procedurat zyrtare për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për sistemin e aplikimit të votuesve jashtë vendit për të qenë në listën e votuesve.

## Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

### QBD sjell në një botim shqip-anglisht "Rosaku i shëmtuar" dhe "Kësulëkuqja"



"Rosaku i shëmtuar" dhe "Kësulëkuqja", dy nga përrallat më të dashura për fëmijët, pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh" - projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe anglisht. Libri i sjellë në shqip nga Parid Teferiçi dhe i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. "Rosaku i shëmtuar" dhe "Kësulëkuqja", shqip dhe anglisht vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

### "Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

### Klasikët Dygjuhësh / QBD publikon shqip-italisht "Piter Pan" dhe "Bukuroshja e fjetur"



"Piter Pan" dhe "Bukuroshja e fjetur", dy nga përrallat më të dashura për fëmijët, pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh" - projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe italisht. Libri i sjellë në shqip nga Parid Teferiçi dhe italisht nga Griselda Doka, i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. "Piter Pan" dhe "Bukuroshja e fjetur", shqip dhe italisht vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

### Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

### Zvicër / Mësuesit e gjuhës shqipe marrin tekstet mësimore dërguar falas nga QBD



Zvicër, 1006 tekste shkollore dhe plotësuese të paracaktuara për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës shqiptare, dërguar falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën arritën tashmë te mësuesit e shkollave shqipe atje, pikërisht në kohën e duhur për fillimin e vitit të ri shkollor. Tekste të ndryshme shkollore, tekste cilësore që kanë shenjuar letërsinë shqipe, seria më e re e botimeve dygjuhëshe nga Qendra e Botimeve për Diasporën, një sërë vlerash, materialesh të ndryshme didaktike, akses online të botimeve tona dhe të platformës së mësimin shqip "Schoolme" janë tashmë në dispozicion të mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë

### D Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

### KKD / Adriana Bejko

#### "Të mohosh gjuhën shqipe nuk do të thotë të integrohesh me shpejt"



Një intervistë e anëtares së Këshillit Koordinues të Diasporës dhe mësueses së njohur të gjuhës e kulturës shqiptare në Kanada, znj. Adriana Bejko, realizuar nga Shani Pnishi gazetar dhe autor, i cili gjithashtu jeton në Kanada. Një veprimtare e njohur për komunitetin shqiptar jo vetëm në Kanada, por edhe në Diasporë, përpos të tjerash znj. Adriana e vë theksin te rëndësia e madhe e mësimin të gjuhës shqipe dhe e pranimit të gjuhës amtare si pjesë thelbësore e identitetit dhe si mënyra më e mirë dhe më e efektshme për t'u integruar me dinjitet e vlera.

### "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):